



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
SEKTORI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE VEND PUNE PËR KONKURIM

Agjencia e Sigurimit të Depozitave për nevoja të plotësimit të vendeve të punës, shpall për konkurim **1 vend të lirë pune**, në pozicionin si vijon:

- **“Specialist i protokoll – arkivë – magazinës”, pranë Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore.**

Kandidatët që kërkojnë të aplikojnë për konkurim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Kritere të përgjithshme:

- Të kenë si rregull shtetësinë shqiptare;
- Të gëzojnë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushin kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojnë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës sipas kriterëve të miratuara;
- Të jenë të aftë për punë;
- Të mos jenë të dënuar me një vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;
- Të angazhohen të respektojnë zbatimin e ligjit “Për Sigurimin e Depozitave”, të ndryshuar, si dhe dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Kritere specifike për pozicionin e punës “Specialist i protokoll – arkivë – magazinës”, pranë Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave:

- Kandidati duhet të ketë të paktën arsimin e mesëm;
- Arsimi i lartë i preferueshëm;
- Aftësi për të kuptuar propozimet dhe vendimet e çdo niveli dhe për ti zbatuar ato;
- Të kenë aftësi për të kryer me përgjegjësi detyrën në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
- Aftësi komunikuese me shkrim (në hartimin e shkresave zyrtare) e me gojë;





- Njohuri në përdorimin e programeve bazë kompjuterike Word, Excel, Power Point;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Të ketë aftësi shumë të mira të komunikimit dhe punës në grup;
- Të jetë i aftë të kryejë detyra të tjera të caktuara nga eprorët përkatës.

Fushat e njohurive, dhe literatura mbi të cilat do të zhvillohet testimi dhe intervista për pozicionin e punës “Specialist i protokoll – arkivë – magazinës”, pranë Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore, në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë;
- Njohuritë mbi ligjin për Sigurimin e Depozitave;
- Njohuritë mbi Statutin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave;
- Njohuritë mbi ligjin për arkivat;
- Njohuritë mbi ligjin për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare;
- Njohuritë mbi kodin etik në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave;
- Njohuritë mbi rregulloren për punën me dokumentat administrative dhe korrespondencën elektronike në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave;
- Njohuritë mbi rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

Kandidatët që do të aplikojnë për konkurim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Curriculum Vitae;
- Diplomë të shkollës së mesme apo të lartë (sipas kërkesës së vendit përkatës së punës);
- Listë notash;
- Dokumenti i Laurimit në gradë shkencore, në qoftë se ka;
- Dëshmi të ndryshme kualifikimi dhe specializimi;
- Dëshmi të gjuhëve të huaja;
- Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor;
- Vërtetim nga prokuroria, gjykata dhe dëshmi penaliteti, ku të vërtetohet që nuk jeni i dënuar ose në ndjekje penale;
- Çertifikatë e gjendjes familjare;
- Të mos jetë i larguar nga puna për masa disiplinore në bazë të ligjit për nëpunësin e shërbimit civil në Republikën e Shqipërisë dhe/ ose Kodit të Punës;
- Fotografi 2 copë;





- Fotokopje e ID-së.

Si dhe të paraqiten pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (Rruga Elbasanit, Pall Edil Al It, Nr. 317, Tiranë) për të tërhequr formën e aplikimit, çdo ditë pranë Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore ose mund ta gjejnë atë në link-un e mëposhtëm në faqen tonë zyrtare në internet:

www.asd.gov.al

Konkurimi në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave bëhet në bazë të procedurave të miratuara nga Këshilli Drejtues i Agjencisë me dy faza:

1. **Në fazën e parë**, bëhet përzgjedhja e kandidatëve që do t'i nënshtrohen testimit të mëtejshëm, e cila konsiston në verifikimin nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të kërkesave specifike, të përcaktuara në shpalljen për konkurim. Vetëm kandidatët që plotësojnë këto kërkesa, i nënshtrohen fazave të mëtejshme të konkurimit.
2. **Në fazën e dytë**, zhvillohet testimi i kandidatëve në dy etapa:
 - i. për zotërimin e gjuhës angleze;
 - ii. për nivelin e njohurive profesionale.

Në qoftë se rezultati i testimit për zotërimin e gjuhës së huaj është nën nivelin minimal të përcaktuar, kandidati nuk kualifikohet për fazat e mëtejshme të konkurimit.

Dokumentacioni të paraqitet në formë shkresore dhe elektronike me email brenda datës 26.06.2024. Pas kësaj date nuk pranohet asnjë dokument. Data e zhvillimit të fazës së dytë të konkurimit do të caktohet në një njoftim të dytë.

- Kandidati, i cili dëshiron të konkurrojë, mund të paraqitet çdo ditë pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për tu njohur me kriteret e vendeve të punës të shpallura për konkurim dhe për të plotësuar kërkesën përkatëse sipas formatit të miratuar nga Agjencia;
- Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, i mbyllur në zarf me adresën përkatëse dhe të jetë i plotësuar sipas kërkesave të mësipërme, si dhe në formë elektronike në adresën lhado@asd.gov.al

(Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar, mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit).

